



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË
KRYETARI

N^o 60 Prot.

Datë 27 / 1 / 2025

URDHËR

N^o 28

«Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë»

Në bazë dhe në përputhje me (i) nenin 3 të ligjit me N^o8096, datë 21.03.1996, «Për kinematografinë», të ndryshuar, si dhe (ii) vendimit të Këshillit të Ministrave me N^o602, datë 21.8.2003, «Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare Kinematografike», të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e «Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», sipas tekstit të bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Shfuqizohet «Rregullorja e Përgjithshme e Mbështetjes Financiare dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», e miratuar nga Kryetari, me N^o168 prot., e datës 27.05.2024, së bashku me të gjitha aktet që e kanë ndryshuar atë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E MBËSHTETJES FINANCIARE DHE LEJEVE E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

E.C.

KREU - I - TË PËRGJITHSHME.....	3
KREU - II - FONDET DHE TË ARDHURAT E QKK.....	3
KREU - III - DETYRAT KRYESORE TË QKK	3
I. Detyrat kryesore të QKK janë por nuk kufizohen:	3
II. Mbështetja financiare e projekteve	5
III. Detyrat administrative dhe organizative të QKK janë si më poshtë:	5
KREU - IV - MËNYRA E FINANCIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE KINEMATOGRAFIKE	6
I. Financimi i projekteve kinematografike realizohet nga QKK në dy mënyra:6	
II. Përzgjedhja e projekteve nga KMP-të, kryhet në 4 faza:	7
1. Prezantimi i projektit nga aplikantët (pitching)	7
2. Vlerësimi i projekteve nga anëtarët e KMP	7
3. Votimi i projekteve nga anëtarët e KMP	7
4. Përzgjedhja e projekteve fituese	7
KREU - V - MARRËDHËNIET E QKK ME PRODUCENTËT/SHTËPITË KINEMATOGRAFIKE, DISTRIBUTORËT, DIFUZORËT DHE SALLAT E KINEMAVE	7
I. Regjistrimi në QKK	7
II. Lejimi i xhirimeve të produksioneve vendase dhe të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë:	9
III. Paraqitja e projektit për konkurim:	9
IV. Rregulla të përgjithshme për aplikim:.....	10
A. - Producenti.....	10
B. - Regjisor	10
C. - Producent dhe regjisor.....	10
D. - Të tjera	11
V. Kriteria të detyrueshme për kualifikimin në konkurim	11
1. Projekte për Film Artistik me Metrazh të Gjatë:	11
2. Projekte për Film Artistik me Metrazh të Gjatë - Vepër e Parë dhe e Dytë:	11

E.C.

3. Projekte për Film Artistik me Metrazh të Shkurtër:	12
4. Projekte për Film Dokumentar:	12
5. Projekte për Film të Animuar:.....	13
6. Projekte për Postproduksion dhe Distribucion:	13
7. Projekte për Vepra Audiovizuale:	14
8. Projekte të Ndryshme Kinematografike	14
9. Projekte për Koproduksion në Pakicë (Minority Coproduction).....	15
VI. Rregulla të përgjithshme për financim.....	15
VII. Nënshkrimi i Kontratës.....	16
VIII. Termat Kryesore të Kontratës.....	17
IX. Të Drejta dhe detyrime të tjera para mbylljes së Projektit	17
KREU - VI - PROJEKTET E KOPRODUKSIONEVE NË PAKICË.....	18
I. Përkufizime.....	18
II. Rregullat e përgjithshme për financim.....	18
KREU - VII - DOKUMENTACIONI I DOSJES SË PROJEKTIT.....	18
1. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË	18
2. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË- VEPËR E PARË DHE E DYTË	20
3. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË SHKURTËR.....	21
4. PROJEKTE PËR FILM DOKUMENTAR	22
5. PROJEKTE PËR FILM TË ANIMUAR	23
6. PROJEKTE PËR PROMOVIMIN E KINEMATOGRAFISË SHQIPTARE JASHTË DHE BRENDA VENDIT	24
7. PROJEKTE TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE.....	24
8. PROJEKTE PËR ZHVILLIM TË FILMAVE ARTISTIKË	25
9. PROJEKTE PËR KOPRODUKSION NË PAKICË	27
10. PROJEKTE PËR POSTPRODUKSION DHE DISTRIBUCION	28
11. PROJEKTE AUDIOVIZUALE	29
KREU - VIII - DISPOZITA TË FUNDIT	30

E. Ç.

KREU - I - TË PËRGJITHSHME

1. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë rregullat dhe kushtet përmes të cilave Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) mbështet financiarisht projektet kinematografike, regjistron producentët, distributorët, sallat, difuzorët si dhe lëshon lejet e qarkullimit për filmat dhe produktet audiovizuale të cilat qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë.

2. BAZA LIGJORE

Kjo Rregullore hartohet në zbatim të ligjit 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", (i ndryshuar), si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
Konventën e Bernës "Për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike", miratuar me Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.487 Datë 9.3.1993;
ligjin nr. 109/2021 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Bashkëproduksionin Kinematografik (e rishikuar), Rotterdam, 30.01.2017;
Komunikatën e Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore për filmat dhe veprat e tjera audiovizive (Tekst me rëndësi për ZEE) (2013/C 332/01);
ligjin nr. 35/2016 "Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me to" (i ndryshuar).

KREU - II - FONDET DHE TË ARDHURAT E QKK

1. QKK administron fonde publike, të përcaktuara si zë më vete në buxhetin e shtetit.
2. Të ardhurat e QKK përbëhen nga:
 - a) Të ardhurat nga shitja, distribucioni dhe shfrytëzimi i veprave filmike, të prodhuara me financimin e QKK.
 - b) Të ardhurat që realizohen nga shfrytëzimi i produksionit kinematografik të Kinostudios "Shqipëria e Re" deri në vitin 1990.
 - c) 1% e të ardhurave të realizuara nga shitja e biletave në kinema.
 - d) Tarifat e regjistrimit të producentëve, distributorëve, sallave si dhe ato për kategorizimin dhe licencimin e filmave që shfrytëzohen duke qarkulluar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - e) Të ardhura të tjera nga sponsorë, organizata, donatorë e partnerë të huaj dhe vendas.

KREU - III - DETYRAT KRYESORE TË QKK

I. DETYRAT KRYESORE TË QKK JANË POR NUK KUFIZOHEN:

1. Përcakton shpërndarjen e fondit buxhetor për gjinitë e filmit (artistik, dokumentar e

E. Ç.

të animuar).

2. Shpërndan fondin për projektet që përmbushin kërkesat e rregullores për produksionin dhe shpërndarjen e filmit dhe që kanë vlera cilësore dhe interes kulturor kombëtar, gjithashtu raporton për realizimin e projekteve dhe fondeve të miratuara.
3. Miraton projektet për realizimin e veprave filmike të një producenti shqiptar, të producentëve shqiptarë a të huaj, kur jepen fonde nga QKK.
4. Përcakton fondet për festivale e javë filmi kombëtare e ndërkombëtare.
5. Propozon ndryshime dhe përmirësime në ligje, vendime, urdhra e urdhëresa të fushës dhe, veçanërisht, për masat organizative, teknike, ligjore dhe financiare, për një funksionim më të mirë të sistemit ligjor kombëtar të filmit, të cilat, pasi shqyrtohen nga Ministria përgjegjëse për Kulturën, paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave nëpërmjet Ministrit përgjegjës për Kulturën.
6. Organizon dhe mbështet financiarisht kualifikimin, specializimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj, si dhe botimet e ndryshme mbi veprimtarinë kinematografike dhe audivizuale.
7. Regjistron të gjithë personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e produksionit dhe të shpërndarjes së filmave, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore, si dhe pajis me certifikatë për ushtrimin e këtyre veprimtarive të gjithë aplikantët, që plotësojnë kushtet e nevojshme, të përcaktuara në rregullore.
8. Regjistron të gjithë personat fizikë e juridikë që zotërojnë sallat a mjedise të tjera për shfaqjen e veprave filmike, sipas rregullores së shpërndarjes dhe shfaqjes së veprave filmike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
9. Regjistron dhe pajis me leje qarkullimi filmat e realizuar ose të importuar që do të shfaqen në territorin e Shqipërisë.
10. Kontrollon zbatimin e standardeve teknike të aparaturave që funksionojnë në Shqipëri për produksionin dhe shpërndarjen e veprave filmike.
11. Organizon kualifikimin, specializimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj.
12. Informon producentët për mundësitë e saj financiare, për ndryshimet në këshillat e saj miratues, për ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore dhe për pjesëmarrjen në festivale e javë të filmit kombëtar e ndërkombëtar.
13. Shqyrton paraprakisht, nga ana formale, kriteret dhe dokumentacionin e projekteve të paraqitura për miratim nga Këshillat Miratues të Projekteve.
14. Analizon dokumentacionin tekniko-ekonomik të projekteve të paraqitura, duke zbatuar normativat e miratuara prej saj.
15. Mbështet financiarisht, me një fond të veçantë buxhetor, projektet e shpërndarjes së veprave filmike shqiptare, brenda dhe jashtë vendit.

E. G.

II. MBËSHTETJA FINANCIARE E PROJEKTEVE

1. Mbështetja financiare për zhvillim të projekteve kinematografike dhe audiovizuale.
2. Mbështetja financiare e projekteve kinematografike me autorë shqiptarë në kategoritë:
 - a. Projekte për filma artistikë me metrazh të gjatë.
 - b. Projekte për filma artistikë me metrazh të gjatë - vepër e parë dhe e dytë.
 - c. Projekte për filma artistikë me metrazh të shkurtër.
 - d. Projekte për filma dokumentarë.
 - e. Projekte për filma të animuar.
 - f. Projekte për postproduksion dhe distribucion.
 - g. Projekte për vepra audiovizuale.
3. Mbështetja financiare e projekteve për koproduksion në pakicë (minority coproduction).
4. Mbështetja financiare e projekteve për promovimin e kinematografisë shqiptare jashtë dhe brenda vendit:
 - a. Projekte për distribuimin, difuzimin, promovimin jashtë dhe brenda vendit të filmave që administrohen, apo janë mbështetur financiarisht nga QKK.
 - b. Projekte për pjesëmarrje në festivale dhe tregje filmi (kombëtare apo ndërkombëtare), si dhe organizimi i pavioneve promovuese në festivale ndërkombëtare të filmit.
5. Financimi i projekteve të ndryshme kinematografike:
 - a. Projekte për ditë, javë dhe festivale filmi (kombëtare dhe ndërkombëtare).
 - b. Projekte kinematografike për kualifikimin, specializimin, përgatitjen dhe trajnimin në vazhdim të kineastëve shqiptarë (konferenca, seminare, punëtori dhe aktivitete të tjera kinematografike).
 - c. Projekte të ndryshme kinematografike për botime dhe përkthime librash kinematografikë, apo ngjarje të ndryshme për nder të kineastëve të shquar shqiptarë.

III. DETYRAT ADMINISTRATIVE DHE ORGANIZATIVE TË QKK JANË SI MË POSHTË:

1. Administron fondin buxhetor për mbështetjen financiare të projekteve kinematografike, të cilët shpallen fitues nga Këshillat e Miratimit të Projekteve (këtu e më poshtë KMP).
2. Koordinon dhe mbikëqyr të gjitha fazat e produksionit dhe mbështet financiarisht projektet që përmbushin kërkesat e Ligjit dhe kësaj Rregulloreje.
3. Analizon dhe raporton për realizimin e projekteve të mbështetura financiarisht prej saj, dhe mbi ushtrimin financiar të planit të buxhetit në institucionet përkatëse.
4. Regjistron, akrediton dhe kategorizon shoqatat e kineastëve, personat fizikë e juridikë, producentë, distributorë, salla kinemaje (përveç personave juridikë publikë, apo subjekteve që gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre nuk kanë qëllim fitimprurës), që



merren me produksionin, distribucionin, shfrytëzimin dhe shfaqjet publike të filmave, duke i pajisur me lejen përkatëse kundrejt pagesës së regjistrimit. Pagesa e regjistrimit përcaktohet me akte nënligjore.

5. Vizionon dhe pajis me leje shfrytëzimi dhe qarkullimi veprat filmike të realizuara brenda vendit, ose të importuara nga jashtë, që shfaqen në sallat e kinemave në territorin e Shqipërisë, nëpërmjet Komisionit të Vizionimit i cili bën klasifikimin e filmit në përputhje me ligjin, si dhe kryen procedurat e nevojshme për pajisjen e filmit me leje qarkullimi dhe shfrytëzimi në territorin e RSH.
6. Kontrollon evidencat e shikueshmërisë përmes raporteve periodike të subjekteve të licencuara për shfrytëzimin përmes qarkullimit të filmave. Këtë informacion e koordinon me strukturat e ministrisë përgjegjëse për financat dhe autoritetet tatimore.
7. Miraton kërkesa për leje xhirimi për produksionet vendase dhe të huaja që xhirojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. Kontrollon zbatimin e standardeve teknike të aparaturave që funksionojnë për produksionin dhe shfaqjen e veprave filmike nëpërmjet strukturës apo personave të autorizuar prej saj.
9. Organizon, koordinon dhe mbështet financiarisht kualifikimin dhe përgatitjen e kineastëve të rinj, duke koordinuar punën me Ministrinë përgjegjëse për Arsimin, Ministrinë përgjegjëse për Kulturën, institucionet arsimore dhe kulturore përkatëse brenda dhe jashtë vendit, si dhe fondacione kombëtare apo ndërkombëtare, që japin ndihmën e tyre në fushën e kinematografisë dhe audiovizualit.
10. Informon krijuesit, producentët për mundësitë financiare të QKK dhe organizatave homologe, ndryshimet në KMP dhe Komisione, aktet ligjore dhe nënligjore, festivalet apo ditët e filmit kombëtare e ndërkombëtare, si dhe për seminare e simpoziume që organizohen apo mbështeten prej saj.

KREU - IV - MËNYRA E FINANCIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE KINEMATOGRAFIKE

I. FINANCIMI I PROJEKTEVE KINEMATOGRAFIKE REALIZOHET NGA QKK NË DY MËNYRA:

1. Shqyrtim në KMP, ku gjykimi bëhet me dosje të hapura:
 - ii. Projekte me autorë dhe produksione ku përvoja dhe sukseset janë të certifikuara në projektet e mëparshme të autorëve (skenarist, regjisor, kompozitor) dhe producentëve që janë vlerësuar apo kualifikuar në konkurim zyrtar në festivale (shih pikën A.1.2/11 të Rregullores së Brendëshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK);
 - iii. Projekte me autorë të nderuar me tituj dhe vlerësime shtetërore jashtë dhe brenda vendit.
 - iv. Projekte për postproduksion dhe distribucion filmi, projekte për vepra audiovizuale, projekte për promocion, distribucion dhe difuzion, projekte të



ndryshme kinematografike.

2. Shqyrtim në Këshillat Miratues të Projekteve (KMP) ku gjykimi i projekteve bëhet anonim për projektet të cilat nuk plotësojnë asnjë nga kriteret e pikës 1 më lart.

II. PËRZGJEDHJA E PROJEKTEVE NGA KMP-TË, KRYHET NË 4 FAZA:

Mbledhjet e KMP-ve zhvillohen fizikisht, në rrjet ose të dyja bashkë.

1. Prezantimi i projektit nga aplikantët (pitching)

Projekti prezantohet nga aplikantët para KMP-ve. Prezantimi zgjat deri në 10 minuta për secilin projekt dhe zhvillimi i kësaj faze është i detyrueshëm.

2. Vlerësimi i projekteve nga anëtarët e KMP

Gjatë fazës së vlerësimit të projekteve, merr pjesë Kryetari i QKK. Në rast se shihet e nevojshme në këtë fazë mund të thërriten specialistë të QKK, për të raportuar rreth çështjeve financiare dhe juridike. Për secilin projekt çdo anëtar i KMP plotëson dhe firmos fishën e leximit.

3. Votimi i projekteve nga anëtarët e KMP

Procedura e votimit të projekteve nga KMP-të, është e përshkruar në Kreun II pika A.1.3 të Rregullores së Brendëshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.

4. Përzgjedhja e projekteve fituese

Dokumenti përfundimtar, vendimi i mbledhjes së KMP-ve, përcakton klasifikimin e projekteve dhe masën e financimit të tyre, bazuar në raportin e vlerësimit të Komisionit Financiar. Në fund vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KMP-ve.

Kryetari i QKK, në konsultim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) të buxhetit, vendos numrin e projekteve që do të financohen sipas fondeve buxhetorë të disponueshme.

KREU - V -

MARRËDHËNIET E QKK ME PRODUCENTËT/SHTËPITË KINEMATOGRAFIKE, DISTRIBUTORËT, DIFUZORËT DHE SALLAT E KINEMAVE

I. REGJISTRIMI NË QKK

1. Producenti/Shtëpia kinematografike (këtu e më poshtë "Producenti") duhet të ketë kryer procedurën e regjistrimit, kur fillon marrëdhëniet financiare me QKK.
2. Producentët, distributorët, difuzorët dhe sallat e shfaqjes publike (kinematë) regjistrohen në QKK çdo vit kalendarik.
3. Tarifat e regjistrimit vjetor janë të përcaktuara në aktet nënligjore.
4. Producentët që regjistrohen për herë të parë për ushtrimin e aktivitetit të tyre,



ngarkojnë në platformën e-albania:

- a. Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në QKK;
 - b. Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit;
 - c. Jetëshkrimin e kërkuesit;
 - d. Diplomë në fushat e kinematografisë, audiovizualit ose shkencave ekonomike e financiare;
 - e. Të paktën dy letra rekomandimi nga producentë me përvojë;
 - f. Të paktën dy kontrata pune në cilësinë e asistentit të produksionit.
 - g. Ekstrakt historik nga QKB.
5. Distributorët dhe difuzorët që regjistrohen për herë të parë për ushtrimin e aktivitetit të tyre, ngarkojnë në platformën e-albania:
- a. Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në QKK;
 - b. Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit;
 - c. Diplomë të arsimit të lartë;
 - d. Jetëshkrimin e kërkuesit;
 - e. Ekstrakt historik në QKB;
 - f. Fotokopje të liçencës së AMA për difuzorët.
6. Sallat e shfaqjes publike (kinematë) që regjistrohen për herë të parë për ushtrimin e aktivitetit të tyre, ngarkojnë në platformën e-albania:
- a. Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit në QKK;
 - b. Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit;
 - c. Jetëshkrimin e kërkuesit;
 - d. Diplomë të arsimit të lartë;
 - e. Ekstrakt historik nga QKB.
7. Producentët, distributorët difuzorët dhe sallat e shfaqjes publike (kinematë) që regjistrohen periodikisht për ushtrimin e aktivitetit të tyre, ngarkojnë në platformën e-albania:
- a. Faturën për kryerjen e pagesës së tarifës së regjistrimit periodik në QKK;
 - b. Letërnjoftimin ose pasaportën e administratorit.
8. Nëpunësi që administron sistemet AMS dhe SQDNE verifikon në sistem edhe ekstraktin e subjektit mbi objektin e aktivitetit të subjektit aplikues.
9. Procedura e regjistrimit vjetor kryhet në platformën e-albania, në varësi të llojit të shërbimit që kërkohet të ofrohet.
10. Pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm, QKK pajis producentët, distributorët, difuzorët dhe sallat e shfaqjes publike (kinematë) me lejen përkatëse sipas objektit të veprimtarisë.
11. QKK mund të refuzojë lejen në rast mungese apo pasaktësie të dokumentacionit të aplikantit.

E.4.

II. LEJIMI I XHIRIMEVE TË PRODUKSIONEVE VENDASE DHE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

Për t'u pajisur me leje xhirimi produksionet (vendase apo të huaja) duhet të paraqesin në QKK dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Kërkesë për pajisje me leje xhirimi;
- b. Sinopsis të projektit filmik;
- c. Ekstrakt të kompanisë së Produksionit dhe CV të saj;
- d. Informacion për bashkëproducentët e projektit filmik (në rast se ka);
- e. Përshkrim i vendeve ku do të kryhen xhirimet;
- f. Plani kalendarik i xhirimeve;
- g. Informacion ku të përshkruhen nevojat për mbështetje nga strukturat publike si Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, Autoritetet vendore, etj., për vënien në dispozicion për xhirime të objekteve të ndryshme, rekuizitë, materiale piroteknike, armatim për përdorim filmik, kostume, uniforma, personel, etj.

Nuk do të pajisen me leje projektet filmike të cilat:

- a. Nxisin hapur shkeljen e të drejtave themelore dhe kushtetuese të njeriut;
- b. Cënojnë nderin dhe prestigjin e historisë dhe të kombit shqiptar;
- c. Kanë përmbajtje apo nxisin ndjenja urrejtje, raciste, etnike, fetare, terrorizëm, etj;
- d. Ngrenë kultin e dhunës dhe kultivojnë ideologji fundamentaliste, etj;
- e. Provokojnë urrejtjen sociale, racore ose çdo formë tjetër diskriminimi;

III. PARAQITJA E PROJEKTIT PËR KONKURIM:

1. Producentët paraqesin projektet për konkurim në rrugë elektronike, në faqen e internetit e-Albania. Deri në aktivizimin e shërbimeve në e-albania aplikimet do të kryhen në rrugë elektronike përmes adresës email info@qkk.gov.al . Dokumentat e aplikimit ngarkohen vetëm me lidhje (link) në platformat e specializuara WeTransfer, MyAirBridge ose SwissTransfer.
2. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve do të skualifikojë projektet që nuk paraqesin (ngarkojnë në sistem) të gjithë dokumentacionin e përcaktuar "I detyrueshëm", apo që paraqesin (ngarkojnë në sistem) dokumenta të pavlefshme.
3. Dokumentat që kanë nevojë për nënshkrim do të ngarkohen të skanuara, pasi të jenë nënshkruar / vulosur (sipas rastit).
4. Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve (KSHPP), konform procedurës me të cilën operon, vendos për projektet që janë paraqitur (ngarkuar në sistem) në mënyrë korrekte, të cilët do të kalohen për shqyrtim në KMP.
5. Aplikantëve mund t'i kërkohen të dhëna shtesë nga KSHPP.



6. Projekti do të skualifikohet në rast se producenti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar nga KSHPP. Argumentimi i KSHPP për arsyet e skualifikimit, i përcillet producentit nga specialisti i projekteve.
7. Financimet private do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse garantohen nëpërmjet një Deklarate Bankare e cila vërteton depozitimin e fondeve në emër të projektit.
8. Për projektet e shpallura fituese nga KMP-të, producenti duhet të dorëzojë dokumentacionin original pranë Drejtorisë së Projekteve të QKK përpara nënshkrimit të kontratës së financimit.

IV. RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKIM:

A. - Producenti

1. Ka të drejtë të paraqesë për konkurim vetëm 1 (një) projekt për çdo kategori konkurimi;
2. Ka të drejtë të paraqesë për konkurim vetëm 1 (një) projekt për film artistik me metrazh të gjatë në një sezon konkurimi pavarësisht nga kategoria;
3. Ka të drejtë të paraqesë jo më shumë se 2 (dy) projekte në një sezon konkurimi;
4. Nuk mund të paraqesë projekt për aplikim, në rast se ka 2 (dy) kontrata në proces financimi. Përjashtim nga ky përcaktim bëjnë:
 - a. Projekte të kategorisë “Projekte të ndryshme kinematografike”.
 - b. Projekte të kategorisë “Koproduksione në Pakicë”.
5. Duhet të garantojë se aplikon në QKK për financim maxhoritar, si dhe që shtetësia e filmit të ardhshëm do të jetë shqiptare.
6. Producentët që nuk kanë nënshkruar asnjë kontratë me QKK, mund të aplikojnë në kategorinë film artistik me metrazh të shkurtër, film artistik dokumentar, apo film të animuar, vetëm pasi të paraqesin kontratë bashkëpunimi me një producent në rolin e producentit ekzekutiv. Ky i fundit, duhet të ketë përmbyllur të paktën 2 (dy) kontrata të përfunduara financimi me QKK, në cilësinë e producentit. Në rast se projekti konkurues shpallet fitues, kontrata ndërmjet tyre do të nënshkruhet para noterit.
7. Në rast mosmarrëveshje me producentin ekzekutiv gjatë produksionit, ndryshimi i producentit ekzekutiv, bëhet me miratimin e QKK sipas kushteve të lartpërmendura.

B. - Regjisor

1. Ka të drejtë të konkurojë vetëm me 1 (një) projekt në një sezon konkurimi.
2. Nuk ka të drejtë të paraqesë projekt për konkurim nëse producenti nuk ka përmbyllur filmin duke kryer depozitën legale në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF) dhe mbylljen e dosjes administrative dhe financiare të projektit paraardhës pas mbajtjes së premierës së filmit.

C. - Producent dhe regjisor

1. Në rastet kur Producenti është edhe Regjisor i projektit kinematografik:



- a. Aplikimi për projektin e radhës do të kryhet vetëm pasi të ketë kaluar 1 (një) vit nga data e premierës zyrtare të veprës së fundit filmike të mbështetur financiarisht nga QKK.
- b. Në dokumentat e aplikimit duhet të depozitohet Kontratën me Producentin Ekzekutiv me përvojë që do të angazhohet në Projekt. Në rast se projekti konkurues shpallet fitues, kontrata e punësimit ndërmjet tyre do të nënshkruhet para noterit.

D. - Të tjera

1. Do të pranohen në konkurim vetëm projektet që kërkojnë financim mazhoritar në QKK dhe që garantojnë paraprakisht se nënshtetësia e filmit të ardhshëm do të jetë shqiptare.
2. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve, nuk do të kualifikojë në konkurim projekte filmike, që kanë konkuruar dy herë dhe nuk janë shpallur fitues nga KMP-të.
3. Sesionet e konkurimit për projekte kinematografike hapen si rregull të paktën 2 (dy) herë në vit, në raste të veçanta dhe në varësi të situatës financiare mund të hapen thirrje të tjera.
4. Hapja e konkurseve shpallet publikisht dhe i njoftohet producentëve dhe kineastëve në faqen zyrtare të internetit të QKK, në Buletinin Zyrtar të Kinematografisë, në faqen zyrtare www.qkk.al si dhe në mjetet e tjera të komunikimit elektronik.
5. Afati i aplikimit për konkurset për film artistik me metrazh të gjatë dhe film artistik vepër e parë dhe e dytë të jetë të paktën një muaj nga data e shpalljes. Për të gjitha projektet e tjera kinematografike ky afat mund të jetë më i shkurtër.

V. KRITERE TË DETYRUESHME PËR KUALIFIKIMIN NË KONKURIM

Krahas rregullave të përgjithshme për aplikim, të përshkruara në nënpikën III (më sipër) për secilin lloj të projekteve, duhet të mbahen parasysh edhe kriteret e detyrueshme si më mëposhtë:

1. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë përmbushur të paktën tre kontrata financimi me QKK, dy prej të cilave të jenë filma artistikë metrazh të gjatë - vepër e parë dhe vepër e dytë.
- c. Regjisor i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisor i projektit duhet të ketë realizuar të paktën tre filma, nga të cilët dy filma me metrazh të gjatë - vepër e parë dhe vepër e dytë, me financimin e QKK ose me fonde publike organizmave të huaja homologe të QKK apo me fonde të pavaruara.
- e. Së paku njëra prej veprave të mëparëshme të jetë përzgjedhur në konkurimin zyrtar të festivaleve të akredituara nga FIAPF përcaktuara në Kreu II / A.1.2, nënpika 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.

2. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË - VEPËR E PARË DHE E DYTË:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy vepra filmike, nga të cilët njëra me



financimin e QKK.

- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit me metrazh të gjatë - vepër e parë dhe e dytë, duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi në institucionet e arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin konform procedurave ligjore në fuqi.
 - ii. realizuar më parë të paktën dy filma artistikë me metrazh të gjatë / të shkurtër / film dokumentar të financuar nga QKK ose me fonde publike organizmave të huaja homologe të QKK.
 - iii. punuar si asistent i regjisë në së paku në dy filma apo produkte audiovizuale të mbështetura financiarisht nga QKK pas studimeve.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën d (më sipër) duhet të ketë realizuar një film artistik me metrazh të gjatë (me fonde të pavarura), i cili është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreu II / A.1.2, nënpike 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.
- f. Regjisorët që kanë përfunduar studimet përpara viteve 1995 mund të dëshmojnë përvojën e tyre profesionale nëpërmjet dëshmimeve si më poshtë:
 - i. deklarata nga autorët me cilët kanë punuar;
 - ii. materiale nga filmat ku kanë punuar (foto nga titrat e filmit);
 - iii. Dokumente të ndryshme që dëshmojnë përvojën.

3. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË SHKURTËR:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik, ose person fizik shqiptar.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë :
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.
 - ii. punuar së paku në dy filma si asistent i regjisë pas studimeve.
- d. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën c më sipër duhet të ketë realizuar një film artistik me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreu II / A.1.2, nënpike 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.
- e. Regjisorët që kanë përfunduar studimet përpara viteve 1995 mund të dëshmojnë përvojën e tyre profesionale nëpërmjet dëshmimeve si më poshtë:
 - iv. deklarata nga autorët me cilët kanë punuar;
 - v. materiale nga filmat ku kanë punuar (foto nga titrat e filmit);
 - vi. Dokumente të ndryshme që dëshmojnë përvojën.

4. PROJEKTE PËR FILM DOKUMENTAR:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik, ose person fizik shqiptar.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit.

E.Ç.

Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.

- ii. punuar së paku në dy filma si asistent pas studimeve.
- d. Regjisori, i cili nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën c më sipër duhet të ketë realizuar një film dokumentar me fonde të pavarura ose me financimin e QKK, i cili të jetë kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e mirënjohura të filmit dokumentar në botë dhe Evropë.
- e. Regjisorët që kanë përfunduar studimet përpara viteve 1995 mund të dëshmojnë përvojën e tyre profesionale nëpërmjet dëshmimeve si më poshtë:
 - vii. deklarata nga autorët me cilët kanë punuar;
 - viii. materiale nga filmat ku kanë punuar (foto nga titrat e filmit);
 - ix. Dokumente të ndryshme që dëshmojnë përvojën.

5. PROJEKTE PËR FILM TË ANIMUAR:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar në rastin e filmit të animuar me metrazh të mesëm ose të gjatë, ose person fizik shqiptar në rastin e filmit të animuar me metrazh të shkurtër.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.
 - ii. punuar së paku në dy filma të animuar si asistent pas studimeve.
- d. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën c më sipër duhet të ketë realizuar një film të animuar me fonde të pavarura ose me financimin e QKK, i cili të jetë kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreu II / A.1.2, nënpike 11 të Rregullores së Brendëshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.
- e. Regjisorët që kanë përfunduar studimet përpara viteve 1995 mund të dëshmojnë përvojën e tyre profesionale nëpërmjet dëshmimeve si më poshtë:
 - vi. deklarata nga autorët me cilët kanë punuar;
 - vii. materiale nga filmat ku kanë punuar (foto nga titrat e filmit);
 - viii. dokumente të ndryshme që dëshmojnë përvojën.

6. PROJEKTE PËR POSTPRODUKSION DHE DISTRIBUCION:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë prodhuar së paku dy filma nga të cilët njëri me financimin e QKK,
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.
 - ii. punuar së paku në dy filma si asistent i regjisë pas studimeve.

E.C.

- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën d më sipër duhet të ketë realizuar një film me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreu II / A.1.2, nënpika 11 të Rregullores së Brendëshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.
- f. Regjisorët që kanë përfunduar studimet përpara viteve 1995 mund të dëshmojnë përvojën e tyre profesionale nëpërmjet dëshmimeve si më poshtë:
 - vii. deklaratë nga autorët me cilët kanë punuar;
 - viii. materiale nga filmat ku kanë punuar (foto nga titrat e filmit);
 - ix. Dokumente të ndryshme që dëshmojnë përvojën.
- j. Producenti nuk duhet të ketë marrë mbështetje financiare nga QKK, për projektin me cilin aplikon për postproduksion dhe distribucion.

7. PROJEKTE PËR VEPRÄ AUDIOVIZUALE:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy vepra filmike, nga të cilët njëra me financimin e QKK.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.
 - ii. punuar së paku në dy seriale si asistent i regjisë pas studimeve.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën d më sipër duhet të ketë realizuar së paku një serial, me fonde të pavarura i cili të jetë difuzuar në rrjete televizive kombëtare apo ndërkombëtare, platforma me ose pa pagesë dhe platforma të tjera të dedikuara apo të ketë marrë pjesë në festivale të mirnjohura të serialeve.
- f. Regjisorët që kanë përfunduar studimet përpara viteve 1995 mund të dëshmojnë përvojën e tyre profesionale nëpërmjet dëshmimeve si më poshtë:
 - v. deklaratë nga autorët me cilët kanë punuar;
 - vi. materiale nga filmat ku kanë punuar (foto nga titrat e filmit);
 - vii. Dokumente të ndryshme që dëshmojnë përvojën.

8. PROJEKTE TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik ose person fizik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë përmbyllur me sukses të paktën një projekt me financimin e QKK.
- c. Drejtuesi i projektit mund të ketë shtetësi shqiptare apo të huaj dhe të ketë përvoja të mëparshme në organizimin e aktiviteteve të ngjashme brenda ose jashtë vendit.
- d. Drejtuesi i projektit duhet të ketë
 - i. përfunduar studimet e larta brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.
 - ii. punuar së paku në dy projekte të ngjashme brenda ose jashtë vendit.
- e. Për projekte distribuimi, difuzimi, promovimi brenda ose jashtë vendit,

E. Ç.

producentët duhet të paraqesin marrëveshje në parim për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e veprave që kërkojnë mbështetje financiare nga QKK.

- f. Për projektet e botimeve letrare në fushën e kinematografisë, producenti që paraqet kërkesën për financim, duhet të depozitojë kontratat me autorin dhe me shtëpinë botuese.

9. PROJEKTE PËR KOPRODUKSION NË PAKICË (MINORITY COPRODUCTION)

- a. Producenti aplikues duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti shqiptar, duhet të ketë përmbyllur të paktën 2 (dy) filma artistikë me metrazh të gjatë, njërin prej të cilëve me financim nga QKK.
- c. Producenti maxhoritar, duhet të ketë siguruar minimalisht 70% të buxhetit të filmit të parashikuar në kontratën e koproduksionit.
- d. Projekti të ketë marrë mbështetje financiare prej institucioneve publike nga vendi i origjinës (e vlefshme për vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian).
- e. Regjisori duhet të ketë realizuar më parë të paktën një film me metrazh të gjatë të mbështetur me fonde publike.
- f. Kontributet në natyrë (in kind) dhe vënie në pjesëmarrje (diferrals), do të pranohen si fonde të konfirmuara deri në një maksimum prej 15% të buxhetit total të koproduksionit.

VI. RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR FINANCIM

1. Producenti mund të nënshkruajë dy kontrata, por nuk mund të financohet për realizimin e dy projekteve në të njëjtën kohë. Përjashtim nga ky përcaktim bëjnë:
 - c. Projekte të kategorisë “Projekte të ndryshme kinematografike”.
 - d. Projekte të kategorisë “Koproduksione në Pakicë”.
2. Në rastet kur nënshkruhen dy kontrata financimi (përveç rasteve të përjashtuara në pikën 1), financimi i projektit të dytë do të bëhet pasi produksioni të ketë kryer premierën lokale. Zbatimi i projektit të dytë mund të garantohet me fonde të siguruara nga vetë produksioni në mënyrë alternative, ose me fondet e veta.
3. Projektet për film artistik me metrazh të gjatë, si dhe film artistik me metrazh të gjatë - vepër e parë dhe e dytë, janë të detyruar të aplikojnë në Eurimages. Financimi do të akordohet pas konfirmimit zyrtar në kualifikimin për përzgjedhje në Eurimages. Në rast të kundërt, financimi i projektit filmik nga QKK anulohet.
4. Producentët apo autorët të cilat përfshihen në një proces gjyqësor lidhur me projektin, pavarësisht nga gjinia ose kategoria, nuk mund të:
 - a. kualifikohet në konkurim,
 - b. përfitojnë financim fillestar,
 - c. përfitojnë vazhdim të financimit,
 - d. realizohet përmbyllja e projektit.

Në rastet e sipërpërmendura, projekti pezullohet deri në vendimmarrje të formës së prerë të gjykatës.

5. Projektet, në të cilët konstatohet nga Komisioni i Monitorimit se nuk respektohet deklarimi i producentëve për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm, do t'i nënshtrohen vendimmarrjes së KMP-ve lidhur me:

E.Ç.

- a. rishikim të masës së financimit të projektit,
- b. vazhdimësisë së realizimit të projektit,
- c. aplikim i masave administrative ndaj producentit.

VII.NËNSHKRIMI I KONTRATËS

1. Projekti kinematografik, i cili shpallet fitues me vendim të KMP-ve, do të financohet pasi vendimi i KMP-ve të miratohet nga Kryetari i QKK. Në rastet kur Kryetari e kthen me arsyetim me shkrim pa e miratuarvendimin e KMP-ve, këto të fundit rimblidhen dhe rishqyrtojnë të njëjtin rend dite. Vendimi që merret në këtë rast është i formës së prerë.
2. Producenti duhet të paraqitet për të nënshkruar kontratën e financimit për projektin e miratuar,deri në 3 muaj nga data e miratimit të financimit
3. Tejkalimi i afatit të sipërpërmendur, pavarësisht nga arsytet, përfshi edhe pamundësinë e përfundimit të negociatave për nënshkrimin e kontratës, e anullos vendimin e KMP dhe të Kryetarit për financimin e projektit.
4. Në raste të veçanta, sidomos kur situata financiare e QKK e mundëson një gjë të tillë, afatet e sipërpërmendura mund të ndryshohen me vendim të Kryetarit të QKK mbështetur në raportin e Komisionit të Monitorimit të Projekteve.
5. Producenti, para nënshkrimit të kontratës së financimit me QKK, duhet të paraqesë këto dokumenta:
 - a. Preventivin përfundimtar për realizimin e projektit, në përputhje me vlerën e financimit të miratuar nga QKK.
 - b. Kontratën me autorët kryesorë të filmit/projektit.
 - c. Planin kalendarik të realizimit të projektit.
 - d. Kontratë/a koproduksioni (në varësi të llojit të projektit), ose Deklaratë e Produksionit, në të cilën garantohet mbulimi i zërave që nuk financohen nga QKK.
 - e. Dokumenta të tjera që vlerësohen se janë të nevojshme në varësi të llojit të projektit, apo janë caktuar nga KMP-të për t'u paraqitur në këtë fazë.
6. Producenti duhet të paraqesë këto dokumenta shtesë për filmin artistik me metrazh të gjatë:
 - a. Montazhin financiar/Planin Financiar të projektit, ku pasqyrohet financimi i të gjithë koproducentëve;
 - b. Raport i periudhës së zhvillimit të projektit;
 - c. Strategjinë e distribucionit dhe difuzionit të veprës.
7. Para financimit të fazës së xhirimit të filmit, producenti duhet të paraqesë në QKK:
 - a. Kontratat e punësimit të nënshkruara me ekipin teknik, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës si dhe parshikimeve të bëra në preventivin e filmit.



- b. Kontratat e nënshkruara me aktorët kryesorë, rolet e dyta, etj.
- 8. Për projektet e kategorisë Koproduksion në Pakicë (Minority Coproduction) financimi fillestar do të jetë jo më shumë se 80% e fondit të akorduar nga QKK.

VIII. TERMAT KRYESORE TË KONTRATËS

Kontrata e financimit nga QKK, hartohet në zbatim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë ku përfshihen termat e mëposhtëm:

- a. Afatet e realizimit të projektit.
- b. Vlerën dhe periudhat e financimit të projektit nga QKK.
- c. Detyrimin e Produksionit për dorëzimin në QKK të dokumentave justifikuese për shpenzimet financiare të kryera siaps fazave të financimit të puercaktuara në kontratë, të cilat shqyrtohen nga Komisioni Financiar.
- d. Detyrimin për depozitim të situacionit përfundimtar të realizimit të projektit, ku shprehet në përqindje kontributi i secilës palë koproducente.
- e. Sanksionet në rastet e moszbatimit të detyrimeve kontraktore.

IX. TË DREJTA DHE DETYRIME TË TJERA PARA MBYLLJES SË PROJEKTIT

- 1. Në përfundim, para mbylljes së procedurës administrative të projektit filmik, producenti ka detyrim:
 - a. Të depozitojë (depozitë ligjore) nga një kopje të filmit, negativ dhe pozitiv nëse është xhiruar me pelikul ose një Hard Disk format DNG dhe një kopje DCP në AQSHF si dhe një kopje DCP dhe një skedar QuickTime .mp4 në QKK;
 - b. Të paraqesë në QKK, raportin financiar dhe raportin narrativ të realizimit të projektit.
- 2. Premiera kombëtare e filmit të financuar nga QKK:
 - a. Të kryhet brenda afateve të përcaktuara në kontratën e financimit.
 - b. Në titrat e filmit dhe në materialet promocionale të vendoset logo e QKK, e të shkruhet:
“Me mbështetjen financiare të Oendrës Kombëtare të Kinematografisë”
- 3. Producenti që ka marrë fond buxhetor në përfundimin e realizimit të veprës, është i detyruar të paraqesë në QKK:
 - a. raport të hollësishëm për gjithë veprimtarinë e zhvilluar dhe përdorimin e fondit buxhetor;
 - b. deklarin e të ardhurave nga qarkullimi dhe shfrytëzimi i veprës, i cili gjatë vitit të parë të shfrytëzimit bëhet çdo tre muaj, gjatë tre viteve pasardhëse deklarimi bëhet çdo gjashtë muaj, ndërsa për pjesën e mbetur deri në fund të 10 viteve, deklarimi bëhet çdo vit.



KREU - VI - PROJEKTET E KOPRODUKSIONEVE NË PAKICË

I. Përkufizime

Projektet e koproduksioneve në pakicë, "Projekte *Minority Coproduction*", janë projektet filmike, që realizohen në koproduksion, ku produksioni shqiptar është në pakicë. Si të tilla konsiderohen projektet që garantojnë të paktën njërën nga kriteret e mëposhtme:

- a) Projekte filmike të autorëve shqiptarë të konfirmuar nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Greqia;
- b) Projekte filmike të huaja, të cilat plotësojnë, të paktën dy nga kriteret e mëposhtme:
 - i. Filmi trajton temë shqiptare;
 - ii. Një pjesë e xhirimeve të filmit kryhet në Shqipëri;
 - iii. Gjuha origjinale e filmit të jetë gjuha shqipe, në jo më pak se 20% të tij dhe versioni i kopjes përfundimtare të jetë i subtitruar në gjuhën shqipe në pjesët ku nuk flitet shqip.
- c) Projekte filmike të huaja, me interes të veçantë, të cilat garantojnë cilësi përmes autorëve, interpretëve, producentëve, distributorëve të mirënjohur botërisht; dhe do të shpenzojnë në Shqipëri një masë të konsiderueshme të buxhetit të tyre nëpërmjet xhirimeve apo proceseve të tjera të produksionit të filmit.

II. Rregullat e përgjithshme për financim

1. Projektet që do të paraqiten për konkurim në këtë kategori, do të financohen në bazë të vlerësimit të ekspertizës financiare të QKK, por në çdo rast jo më shumë se 7.000.000 (shtatë milionë) Lekë.
2. Financimi që akordohet nga QKK për këto projekte, duhet që të shpenzohet në masën jo më pak se 90% të tij, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky financim do të përdoret për përballimin e shpenzimeve të produksionit, apo për angazhimin e ekipit teknik dhe/ose interpretëve shqiptarë në projektin filmik.
3. Nuk mund të përfitojnë financim projekte të huaja vepër e parë e autorit.
4. QKK do të preferojë projekte të mëdha ndërkombëtare të cilat garantojnë vizibilitet të vendit në festivale të akredituar FIAPF dhe në median e profilizuar ndërkombëtare.
5. Mund të aplikojnë për financim në pakicë vetëm producentë shqiptarë dhe shtëpi kinematografike me përvojë.

KREU - VII - DOKUMENTACIONI I DOSJES SË PROJEKTIT

1. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë e motivuar për financimin e projektit kinematografik,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i filmit,
4. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
5. Përmbledhja e skenarit – deri në 2 faqe,
6. Përmbledhja e skenarit – deri në 20 faqe,
7. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.),
8. Skenari përfundimtar (shkruar në programin final draft ose ekuivalent),
9. Certifikatë për regjistrimin e skenarit, pranë Ministrisë përgjegjëse për Kulturën,
10. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj,
11. Vizioni i regjisorit/Trajtimi regjisorial i veprës së ardhshme – deri 3 faqe,
12. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen veprat e mëparëme, vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK, për filmat paraardhës, në rast se ka,
13. Shënimet e Producentit- Vizioni i producentit për montazhin financiar të projektit (strategjia e produksionit dhe distribucionit të projektit),
14. Link në Vimeo të shoqëruar me fjalëkalim të të paktën tre veprave të mëparshme të produksionit,
15. C.V. e Skenaristit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmat paraardhës, në rast se ka,
16. C.V. e Regjisorit ku të pasqyrohen të paktën tre filma të mëparshëm, vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmat paraardhës, në rast se ka,
17. Link të pjesëmarrjes në konkurim zyrtar në festival/e ndërkombëtare të filmit të fundit të Regjisorit, si dhe link/s të çmimeve të fituara në rast se ka,
18. Link në Vimeo të shoqëruar me fjalëkalim të të paktën tre veprave të mëparshme të regjisorit,
19. Aktmarrëveshje paraprake me autorët kryesorë realizues të projektit.
20. Aktmarrëveshje me Producentin Ekzekutiv që do të angazhohet në realizimin e projektit (në rast se producenti është edhe regjisor),
21. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e QKK dhe të ardhurat e realizuara,
22. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
23. Deklaratë për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm,
24. Deklaratë e skenaristit.
25. Planin kalendarik të realizimit të projektit,

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Ilustrime vizuale me fotografi, story board, kinoprovë provizore, apo xhirime të thjeshta, që ndihmojnë KMP -të për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit,
- b. Aktmarrëveshje paraprake me realizuesit dhe interpretuesit kryesorë të veprës,
- c. Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.



2. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË- VEPËR E PARË DHE E DYTË

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë motivimi për financimin e projektit kinematografik,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i filmit,
4. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
5. Përmbledhja e skenarit – deri në 2 faqe,
6. Përmbledhje e zgjeruar e skenarit - deri në 20 faqe,
7. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre vizual, psikologjik, etj.,
8. Skenari përfundimtar (shkruar në programin final draft ose ekuivalent),
9. Certifikatë për regjistrimin e skenarit, pranë Ministrisë përgjegjëse për Kulturën,
10. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj,
11. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri 3 faqe,
12. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen dy veprat filmike të mëparshme, vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK, për filmat paraardhës, në rast se ka),
13. Shënimet e Producentit- Vizioni i producentit për realizimin e projektit (strategjia e produksionit dhe distribucionit të projektit).
14. Link në Vimeo të shoqëruar me fjalëkalim të të paktën dy veprave të mëparshme të Producentit,
15. C.V. e Skenaristit, ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmat paraardhës, në rast se ka,
16. C.V. e Regjisorit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës ose për filma ku ka punuar si asistent i regjisë shoqëruar me letra rekomandimi nga regjisorit,
17. Diploma e Regjisorit (vërtetim i njësisë me origjinalin). Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë njehsuar nga organet kompetente,
18. Link në vimeo të shoqëruar me fjalëkalim, të së paku dy veprave filmike paraardhëse të regjisorit,
19. Aktmarrëveshje paraprake me autorët kryesorë realizues të projektit,
20. Aktmarrëveshje me Producentin Ekzekutiv që do të angazhohet në realizimin e projektit në rast se producenti është edhe regjisor,
21. Deklaratë në përgjegjësi personale për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e QKK dhe të ardhurat e realizuara,
22. Link/s të pjesëmarrjes në konkurim zyrtar në festival/e ndërkombëtare të filmit të fundit të Regjisorit, si dhe link/s të çmimeve të fituara në rast se ka,
23. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
24. Deklaratë për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm,



25. Deklaratë e skenaristit.
26. Planin kalendarik të realizimit të projektit,

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Ilustrime vizuale me fotografi, story board, casting provizor, apo xhirime të thjeshta, që ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit,
- b. Aktmarrëveshje paraprake me realizuesit dhe interpretuesit kryesorë të veprës,
- c. Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

3. PROJEKTE PËR FILM ARTISTIK ME METRAZH TË SHKURTËR

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë për financimin e projektit kinematografik,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i filmit,
4. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
5. Përmbledhja e skenarit – deri në 3 faqe,
6. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.),
7. Skenari përfundimtar shkruar në programin final draft ose ekuivalent,
8. Certifikatë për regjistrimin e skenarit, pranë Ministrisë përgjegjëse për Kulturën,
9. Vizioni i regjisorit/Trajtimi regjisorial për veprën e ardhshme – deri 3 faqe,
10. Shënimet e Producentit - Vizioni i producentit për realizimin e projektit, strategjia e produksionit dhe distribucionit të projektit,
11. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj.
12. C.V. e Skenaristit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka),
13. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
14. Kontratë me një producent ekzekutiv me përvojë prej së paku tre filmash të financuar nga QKK pavarësisht nga metrazhi,
15. C.V. e Regjisorit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka, ose për filma ku ka punuar si asistent i regjisë shoqëruar me letra rekomandimi nga regjisorit,
16. Diploma e Regjisorit (vërtetim i njësisë me origjinalin). Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë njehsuar nga organet kompetente,
17. Link të pjesëmarrjes në festivale ndërkombëtare të filmave të Regjisorit, si dhe link ose certifikatë të çmimeve të fituara në rast se ka,
18. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalim) të veprës paraardhëse të regjisorit,
19. Aktmarrëveshje paraprake me autorët kryesorë realizues të projektit,
20. Deklaratë në përgjegjësi personale për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me

E. Ç.

- financimin e QKK dhe të ardhurat e realizuara nga shfrytëzimi,
21. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
 22. Deklaratë për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm,
 23. Deklaratë e skenaristit.
 24. Planin kalendarik të realizimit të projektit,

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Ilustrime vizuale me fotografi/story board, të cilat ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit,
- b. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas ose të huaj,
- c. Aktmarrëveshje paraprake me realizuesit/interpretuesit e veprës,
- d. Informacione/shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë prezantimin e projektit.

4. PROJEKTE PËR FILM DOKUMENTAR

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i filmit,
4. Përmbledhja e skenarit – deri në 5 faqe,
5. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
6. Skenari përfundimtar shkruar në programin final draft ose ekuivalent. (Jo i detyrueshëm), ose përshkrim të detajuar të skenave të mundëshme,
7. Certifikatë për regjistrimin e skenarit ose përshkrimit, pranë Ministrisë përgjegjëse për Kulturën,
8. Vizioni i Regjisorit/Trajtimi regjisorial për veprën e ardhshme – deri 2 faqe,
9. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka.
10. Kontratë me një producent ekzekutiv me përvojë prej së paku tre filmash të financuar nga QKK pavarësisht nga metrazhi,
11. Shënimet e Producentit- Vizioni i producentit për realizimin e projektit (strategjia e produksionit dhe distribucionit të projektit),
12. C.V. e Skenaristit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të mirnjohura të filmit dokumentar në botë dhe Evropë,
13. C.V. e Regjisorit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të të mirnjohura të filmit dokumentar në botë dhe Evropë,
14. Diploma e Regjisorit (vërtetim i njësisë me origjinalin). Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë njehsuar nga organet kompetente,
15. Link të pjesëmarrjes në festivale ndërkombëtare filmi, të filmave të Regjisorit, si dhe link ose certifikatë të çmimeve të fituara në rast se ka,
16. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalim) të veprës paraardhëse të regjisorit,
17. Aktmarrëveshje paraprake me autorët e projektit,

€.

18. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e QKK dhe të ardhurat e realizuara,
19. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
20. Deklaratë për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm,
21. Deklaratë e skenaristit.
22. Plani kalendarik i realizimit të projektit,

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Deklaratë për pjesëmarrje në festivale të filmit të mëparshëm, si edhe çmimet e fituara (në rast se ka),
- b. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas dhe/ose të huaj,
- c. Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

5. PROJEKTE PËR FILM TË ANIMUAR

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i filmit,
4. Përmbledhja e skenarit – deri në 5 faqe në varësi të minutazhit të produktit final,
5. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
6. Skenari përfundimtar shkruar në programin final draft ose ekuivalent,
7. Certifikatë për regjistrimin e skenarit, pranë Ministrisë përgjegjëse për Kulturën,
8. Personazhet dhe dekoret. Materializimi i personazheve dhe dekoreve në teknikën dhe formatin me të cilën do të realizohet filmi (vizatim, kolazh, kukulla, plasteline, 3D etj),
9. Story-board,
10. Vizioni i Regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri 2 faqe,
11. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
12. Shënimet e Producentit- Vizioni i producentit për realizimin e projektit (strategjia e prodhimit dhe distribucionit të projektit),
13. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj,
14. C.V. e Skenaristit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
15. C.V. e Regjisorit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka ose për filma animacioni ku ka punuar si asistent i regjisë shoqëruar me letra rekomandimi nga regjisori,

E. Ç.

16. Diploma Bachelor/Master për Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.
17. Link të pjesëmarrjes në konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të filmave të Regjisorit, si dhe link ose certifikatë të çmimeve të fituara në rast se ka,
18. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalimi) të veprës paraardhëse të regjisorit,
19. Aktmarrëveshje paraprake me autorët e projektit,
20. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e QKK dhe të ardhurat e realizuara,
21. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
22. Deklaratë për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm,
23. Deklaratë e skenaristit.
24. Planin kalendarik të realizimit të projektit,

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Pilot ose render 10 - 30 sekonda, i cili do të shërbejë për të krijuar një ide më të qartë rreth qasjes artistike dhe estetike, atmosferës, animacionit, teknikës dhe formatit me të cilin do të realizohet filmi,
- b. Projekti i distribucionit dhe territoret e shitjes së filmit (kontrata aktmarrëveshje, apo letra qëllimi nga distributorë të ndryshëm vendas, apo të huaj),
- c. Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

6. PROJEKTE PËR PROMOVIMIN E KINEMATOGRAFISË SHQIPTARE JASHTË DHE BRENDË VENDIT

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë nga producenti për shqyrtimin dhe financimin e projektit promovues,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i projektit,
4. Plani kalendarik,
5. Aktmarrëveshje paraprake me partnerë të realizimit të aktivitetit, vendas/të huaj,
6. C.V. e shtëpive kinematografike,
7. C.V. e drejtuesit të projektit,
8. Shënimet e aplikantëve për qëllimin e pjesëmarrjes dhe informacione mbi shkëmbimet dhe korrespondancat me partnerë të mundshëm,
9. Raport narrativ për pjesëmarrjet e mëparshëm në aktivitete të ngjashme.

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

7. PROJEKTE TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

E.C.

1. Kërkesë për shqyrtimin dhe financimin e projektit kinematografik,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i projektit,
4. Plani kalendarik,
5. Aktmarrëveshje paraprake me partnerë të realizimit të aktivitetit, vendas/të huaj,
6. C.V. e shtëpisë kinematografike ku të pasqyrohet së paku një projekt me financimin e QKK,
7. C.V. e drejtuesit të projektit, ku të pasqyrohen së paku dy projekte të ngjashme brenda ose jashtë vendit,
8. C.V.-të e ekipit zbatues të projektit (të paktën tre),
9. Shënimet e producentit për realizimin e projektit,
10. Raport narrativ për edicionin e mëparshëm të aktivitetit (nëse nuk është financuar nga QKK),
11. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për të ardhurat e realizuara nga projekte të mëparshëm të prodhuar me financimin e QKK,
12. Marrëveshje në parim për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e veprave që kërkojnë mbështetje financiare nga QKK për projekte distribuimi, difuzimi dhe promovimi,
13. Kontratat me autorin dhe shtëpinë botuese për projektet e botimeve letrare në fushën e kinematografisë,
14. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.

Dokumentacion shitesë (jo i detyrueshëm):

- a. Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

8. PROJEKTE PËR ZHVILLIM TË FILMAVE ARTISTIKË

Me “Zhvillim projekti”, kuptohet ndjekja, frekuentimi i forumeve, laboratorëve, punëtorive, etj., të organizuara nga institucione publike, apo të pavarura, të cilat janë të njohura zyrtarisht në nivel ndërkombëtar dhe konsistojnë në:

1. Zhvillim skenari;
2. Zhvillim produksioni, e cila nënkupton sigurim koproduksioni real vendas ose të huaj, me financime publike, ose private.

Financimet private do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse garantohen nëpërmjet një deklarate bankare e cila vërteton depozitimin e fondeve në emër të projektit.

Kritere të detyrueshme për kualifikim në konkurim në këtë kategori, do të jenë kriteret e detyrueshme të kategorisë përkatëse ku kualifikohet vepra e ardhshme kinematografike. (shih Kreu V, Nën-pika 5 e kësaj rregullore)

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë për financimin e projektit kinematografik,

€ . Ç.

2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i zhvillimit të projektit,
4. Trajtimi artistik (jo më pak se 10 faqe),
5. Synopsis i shkurtër (5 rreshta),
6. Përmbledhja e skenarit (deri 2 faqe),
7. Skenar i plotë në rast se ka,
8. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre vizual, psikologjik, etj.,
9. Strategjia e zhvillimit të projektit/skrenarit e hartuar nga autorët e projektit, seminare dhe forume ndërkombëtare ku planifikoni të prezantoni dhe zhvilloni projektin/skenarin,
10. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
11. Shënimet e Producentit- Vizioni i producentit për realizimin e projektit (strategjia e produksionit dhe distribucionit të projektit),
12. C.V. e Skenaristit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
13. C.V. e regjisorit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka.
14. Aktmarrëveshje paraprake me autorët realizues të projektit.
15. Raport mbi qarkullimin, promovimin, dhe rezultatet e tjera të veprës së mëparshme të regjisorit.
16. Raport mbi qarkullimin, promovimin, dhe rezultatet e tjera të veprës së mëparshme të producentit.
17. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalimi) të veprës së mëparshme të Produksionit.
18. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalimi) të veprës së mëparshme të regjisorit.
19. Listë me link/s të pjesëmarrjes në konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të Filmit të mëparshëm të Regjisorit, si dhe të çmimeve të fituara në rast se ka.
20. Deklarata e Producentit për distribucionin e veprave filmike të mëparshme.
21. Deklaratë e shtëpisë kinematografike.
22. Deklaratë e skenaristit.
23. Plani kalendarik i realizimit të projektit,

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Aktmarrëveshje apo kontrata paraprake me bashkëproducentë (vendas apo të huaj),
- b. Informacione apo shpjegime që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

E. Ç.

9. PROJEKTE PËR KOPRODUKSION NË PAKICË

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë për financimin e projektit kinematografik,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi i filmit, nënshkruar nga të gjithë bashkëproducentët, ku të jetë përcaktuar pjesa e zërave që do të shpenzohet në Shqipëri,
4. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
5. Përmbledhja e skenarit – deri në 20 faqe,
6. Skenari përfundimtar (shkruar në programin final draft ose ekuivalent),
7. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.),
8. Vizioni i Regjisorit/Trajtimi regjisorial për veprën e ardhshme,
9. Link në Vimeo shoqëruar me fjalëkalim, të veprave të mëparshme të Regjisorit,
10. Raport për ecurinë e filmit të mëparshëm të regjisorit,
11. Kontrata e koproduksionit, e nënshkruar nga të gjithë bashkëproducentët, shoqëruar me preventivin e filmit, në të cilin të përcaktohen përqindjet e pjesëmarrjes për secilin bashkëproducent,
12. Plan i financiar i projektit, ku të jenë specifikuar të gjitha burimet e konfirmuara dhe të pritshme për të përfituar mbështetje financiare,
13. Konfirmim/vërtetim/dëshmi (origjinal ose fotokopje e noterizuar), që vërteton se produksioni ka siguruar mbështetje nga fonde publike,
14. Përshkrim i vendeve ku do të realizohen xhirimet e filmit, ku të mirëpërcaktohet kohëzgjatja e xhirimeve në territorin shqiptar,
15. Kontrata e produksionit maxhoritar për marrjen e të drejtave me skenaristin,
16. Kontrata e produksionit maxhoritar për marrjen e të drejtave me regjisorin,
17. C.V. e Produksionit maxhoritar, ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
18. C.V. e shtëpisë kinematografike shqiptare (minority coproduction), ku të pasqyrohen të paktën dy filma artistikë me metrazh të gjatë njëri prej të cilëve me financimin e QKK, vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
19. C.V. e skenaristit, ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
20. C.V. e regjisorit, ku të pasqyrohen realizimi i një filmi me metrazh të gjatë të mbështetur me fonde publike si dhe vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
21. Link në Vimeo shoqëruar me fjalëkalim, të veprave të mëparshme të Regjisorit

E.C.

22. Link të pjesëmarrjes në konkurim zyrtar në festival/e ndërkombëtare të filmit të fundit të Regjisorit, si dhe link/s të çmimeve të fituara (në rast se ka),
23. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e QKK,
24. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
25. Plan i kalendarik i realizimit të projektit.

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Ilustrime vizuale me fotografi, story board, casting provizor, apo xhirime të thjeshta, që ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit,
- b. Projekti distribucioni dhe territoret e shitjes së filmit (kontrata aktmarrëveshje, nga distributorë të ndryshëm vendas/të huaj),
- c. Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

10. PROJEKTE PËR POSTPRODUKSION DHE DISTRIBUCION

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë motivimi për financimin e projektit,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar i filmit,
4. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
5. Përmbledhja e skenarit – deri në 2 faqe,
6. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.),
7. Skenari përfundimtar (shkruar në programin final draft ose ekuivalent),
8. Certifikatë për regjistrimin e skenarit, pranë Ministrisë përgjegjëse për Kulturën,
9. Kontratë noteriale me bashkëproducentë vendas/të huaj nëse ka,
10. Strategjia e distribucionit kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe marrëveshje në parim me distributorë lokalë ose ndërkombëtarë.
11. Vizioni i producentit për produksionin e projektit.
12. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri 3 faqe,
13. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen së paku dy filma nga të cilët njëri me financimin e QKK, si dhe vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka,
14. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalim) montazhit paraprak (rough cut),
15. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalim) të veprës së mëparshme të producentit,
16. C.V. e Skenaristit,
17. C.V. e Regjisorit ku të pasqyrohen, vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës ose për filma ku ka punuar si asistent i regjisë shoqëruar me letra rekomandimi nga regjisorit,
18. Diploma e Regjisorit (vërtetim i njësisë me origjinalin). Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë njehsuar nga organet kompetente,

E.C.

19. Kontratë noteriale me autorët kryesorë realizues të veprës,
20. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e QKK dhe të ardhurat e realizuara nëse ka ,
21. Link/s të pjesëmarrjes në konkurim zyrtar në festival/e ndërkombëtare të filmit të fundit të Regjisorit, si dhe link/s të çmimeve të fituara nëse ka,
22. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
23. Deklaratë për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm,
24. Deklaratë e skenaristit.
25. Planin kalendarik i postproduksionit dhe distribucionit

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

11. PROJEKTE AUDIOVIZUALE

DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë motivimi për financimin e projektit,
2. Formulari i aplikimit,
3. Preventivi financiar,
4. Synopsis i shkurtër – jo më shumë se 5 rreshta,
5. Përmbledhja e skenarit – deri në 2 faqe për episod,
6. Lista e personazheve dhe përshkrimi i tyre (vizual, psikologjik, etj.),
7. Skenari përfundimtar i episodeve të serialit, shkruar në programin final draft ose ekuivalent,
8. Certifikatë për regjistrimin e skenarit, pranë Ministrisë përgjegjëse për Kulturën,
9. Aktmarrëveshje paraprake me bashkëproducentë vendas/të huaj,
10. Kontratë parashitje ose para blerje me rrjete mediatike kombëtare,
11. Vizioni i regjisorit/Platforma regjisoriale për veprën e ardhshme – deri 3 faqe,
12. C.V. e Producentit ku të pasqyrohen së paku dy vepra filmike nga të cilat njëra të jetë realizuar me financimin e QKK si dhe vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare, për filmin paraardhës, nëse ka),
13. Shënimet e Producentit- Vizioni i producentit për realizimin e projektit (strategjia e produksionit dhe distribucionit të projektit).
14. Link në vimeo (të shoqëruar me fjalëkalim) të veprës së mëparshme të producentit,
15. C.V. e Skenaristit,
25. C.V. e Regjisorit ku të pasqyrohen vlerësime me çmim/e dhe/ose konkurim zyrtar në festivale ndërkombëtare të akredituara (shih rregulloren e brendshme të QKK), për filmin paraardhës, në rast se ka, ose për filma ku ka punuar si asistent i regjisë shoqëruar me letra rekomandimi nga regjisorit,
16. Diploma e Regjisorit (vërtetim i njësisë me origjinalin). Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë njehsuar nga organet kompetente,
17. Aktmarrëveshje me autorët kryesorë realizues të veprës,

E.C.

18. Deklaratë (në përgjegjësi personale) për distribucionin/shitjen e filmave të prodhuar me financimin e QKK dhe të ardhurat e realizuara nëse ka,
19. Link të pjesëmarrjes në konkurim zyrtar në festival/e ndërkombëtare të filmit të fundit të Regjisorit, si dhe link të çmimeve të fituara nëse ka,
20. Deklaratë e shtëpisë kinematografike,
21. Deklaratë për nënshtetësinë shqiptare të filmit të ardhshëm,
22. Deklaratë e skenaristit.
23. Planin kalendarik të realizimit të projektit,

Dokumentacion shtesë i rekomandueshëm por jo i detyrueshëm:

- a. Ilustrime vizuale me fotografi, story board, casting provizor, apo xhirime të thjeshta, që ndihmojnë KMP për perceptuar vizionin dhe stilin e regjisorit,
- b. Aktmarrëveshje paraprake me realizuesit dhe interpretuesit kryesorë të veprës,
- c. Informacione që vlerësoni se ndihmojnë në prezantimin e projektit.

KREU - VIII - DISPOZITA TË FUNDIT

1. Anekset e kësaj rregulloreje, miratohen me vendim të Kryetarit.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

E.Ç.